



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:060380  
Datë: 15.11.2024  
Numri i dokumentit: 06459670

**PA1.nr.1416/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryetari i kolegjit, Violeta Husaj Rugova dhe Mehmet Ndrecaj anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e praktikantit Gjqësor Mentor Grajçevci në cilësi të procesmbajtësit, në çështjen penale të akuzuarit B.H nga fshati Cermijan Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nën par 3.1 lidhur me par.1 nën par. 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur përkitazi me ankesën e përfaqësuesit të dëmtuarit të mitur av. Korab Bokshi, të paraqitur kundër aktgjykimit i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr.2024:060380 të dt.12.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.10.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të dëmtuarit të mitur av. Korab Bokshi, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr.2024:060380 të dt.12.07.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr.2024:060380 të dt.12.07.2024, i akuzuari B.H është shpallë fajtorë për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nën par 3.1 lidhur me par.1 nën par. 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe është gjykuar: me dënim me kusht duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj, i cili dënim nuk do të

ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, si dhe nëse i akuzuari gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale dënimi me kusht i shqiptuar mund të revokohet. I dëmtuari E.H me përfaqësuesin e tij ligjor Shpetim Hoxhaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil. Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës për ekspertizën mjeko ligjore në shumë prej njëzet (20) euro, për paushall gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30) euro, si dhe taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit në shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër aktgjykimi të cekur si më lartë, në afat ligjorë ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i të dëmtuarit të mitur av. Korab Bokshi me datë 19.08.2024, për shkak të vendimit mbi sanksionet penale dhe shpenzimet e procedurës penale neni 383 pa.1.4 lidhur me nenin 387 të KPRK-së, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar duke i shqiptuar dënim më të lartë të akuzuarit dhe që ta detyroj të akuzuarin në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale të palës së dëmtuar.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1415/24 të dt.29.08.2024 ka propozuar që të aprovohet ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar E.H av. Korab Bokshi e paraqitur kundër aktgjykimin të ankimuar dhe ti shqiptoj një dënim më të lartë të akuzuarit.

Gjykata e apelit pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës, analizoi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPRK-së dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekuar në ankesa gjeti se:

#### **Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar nuk është e bazuar.**

Gjykata e apelit e ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, bazuar në nenin 394 par. 1 të KPPRK-së, dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar është përpiluar në harmoni të plotë me dispozitat ligjore me saktësisht nenin 369 i KPPRK-së. Po ashtu e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar sipas detyrës zyrtare për shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë as me shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, në radhë të parë për faktin se nga pranimi i fajësisë nga i akuzuari dhe aprovimi i këtyre deklaratave nga Gjykata e shkallës së parë dhe provat e bashkangjitura rezultojnë vërtetimi i gjendjes faktike të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimin të ankimuar, dhe se në veprimet e të akuzuarit janë manifestuar elementet qenësore të kësaj vepre penale për të cilën është shpallur fajtor dhe gjykuar, si dhe marrë parasysh faktin se nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit, dhe ndjekjen penale.

Nga aktgjykimi i shkallës së parë rezulton se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, prandaj gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate. Bazuar në nenin 383 par.2 të KPPRK-së, aktgjykimin e ankimuar Gjykata e Apelit e vlerësoj vetëm në bazë të pretendimeve në ankesë të parashtruara nga përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar për shkak të vendimit mbi dënimin dhe për shkak të shpenzimeve të procedurës penale.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë në me rastin e marrjes së aktgjykimin në pjesën e vendimit lidhur me sanksionet penale ka shqiptuar dënim shumë të ulët dhe jo proporcional me veprimet e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimin. Gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar drejtë dispozitat për rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit. Po ashtu nuk janë dhënë arsyet e duhura, aktgjykimi përmban arsye të gjeneralizuara dhe jo të individualizuara siç kërkohet me ligj dhe dënimi është në disproporcion me veprimet e të akuzuarit. Gjykata ankimore duhet ta harmonizoj dënimin bazuar në udhëzuesin e politikës ndëshkimore të Gjykatës Supreme. Lidhur me kërkesën për gjykimin e shpenzimeve të palës së dëmtuar Gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur fare, ankesë kjo që është orientuar edhe në atë drejtim. Në seancë fillestare pala e dëmtuar ka paraqitur kërkesë për kompensimin e shpenzimeve të domosdoshme procedurale. Duhet pas parasysh se pala e dëmtuar ka qenë i mitur dhe përfaqësimi i tij ka qenë i domosdoshëm. Konform nenit 449 par.2 pika 2.8 të KPPRK-së shpenzimet kanë të bëjnë me mbulimin e shpenzimeve të procedurës për përfaqësuesin e autorizuar të dëmtuarit. Konform tarifës së OAK-së paraqet kërkesën për përfaqësim një seancë 202,80 dhe për përpilimin e ankesës 156,00 euro në shumën e përgjithshme 358,80 euro.

Në raport me pretendimet ankimore për lartësinë e dënimit kolegji penale i kësaj gjykate i ka shqyrtuar rrethanat për dënimin të cilat gjykata e shkallës së parë i ka konstatuar dhe vlerësuar. Nga aktgjykimi i shkallës së parë rezulton se gjykata i ka shqyrtuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana lehtësuese që janë marrë për bazë me rastin e matjes së dënimit të shqiptuar ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë këto rrethana: rrethanat personale të akuzuarit se i njëjti është baba i tre fëmijëve dhe është mbajtës i vetëm i familjes; sjellja e tij ka qenë tejet korrekte me gjykatën duke shprehur pendim për veprën e kryer, faktin se të dëmtuarit dhe familjes së tij iu ka kërkuar falje, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, ku në bazë të të dhënave nga evidenca penale nuk rezulton se më herët ka kryer ndonjë vepër penale, gjithashtu edhe në deklarin e tij në shqyrtim fillestar ka deklaruar kjo është hera e parë që ka kryer një vepër penale dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris më ndonjë vepër penale, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilën ngarkohet. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar moshën e re të dëmtuarit, duke pasur parasysh se vepra penale është kryer ndaj personit të mitur, përkatësisht i dëmtuari në kohën kur është kryer vepra penale ndaj tij ka qenë në moshën 16 vjeçare. E bazuar në këto rrethana gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPPRK-së

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit të parashtruara në ankesa për shqiptimin e një dënimi më të lartë, me pretendim se gjykata nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat për dënimin për të akuzuarit, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate janë të pa bazuara dhe pretendimet e tjera nuk janë të asaj natyre të cilat kishin për të justifikuar dhe ndikuar për një vendim dhe lartësi tjetër nga ai i shqiptuar si në aktgjykimin e ankimuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës penale kolegji i kësaj gjykate ka analizuar pretendimet ankimore dhe dispozitën e nenit 449 par.2 pika 2.8 të KPPRK-së dhe kjo dispozitë ligjore përcakton shpenzimet e procedurës penale. Ndërsa dispozita e nenit 454 par.1 KPPRK-së përcakton se: “ *Shpërblimi dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit ose përfaqësuesit të të dëmtuarit ose viktimës detyrohet t’i paguajë personi i përfaqësuar pavarësisht se kush detyrohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale në bazë të urdhrit të gjykatës, përveç kur mbrojtësi caktohet sipas nenit 56 paragrafit 2 ose 3 apo nenit 57 të këtij Kodi*”. Përfaqësuesi i palës së dëmtuar kërkesën e specifikuar e ka paraqitur vetëm para gjykatës së apelit. Mirëpo bazuar në këtë dispozitë ligjore, pra nenin 454 par.1 të KPPRK-së, parashihet pagesa e shpenzimeve të nevojshme nga vetë personi i përfaqësuar dhe përjashtim bënë kur mbrojtja është e obligueshme. Në këtë rast av. Korab Bokshi e ka përfaqësuar palën e të dëmtuarit në bazë të autorizimit dhe nuk ka të drejtë të kërkojë shpenzimet për përfaqësim. Kolegji rikujton se tek të mitur mbrojtja është obligative kur i mituri paraqiten si kryes të veprave penale, e jo edhe në rastet kur i mituri paraqitet si palë e dëmtuar. Prandaj, kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se pretendimet ankimore janë të pa bazuar dhe se gjykata e shkallës së parë ka vendosur vetëm për shpenzimet për të cilat është i detyruar të vendos në bazë të dispozitave ligjore.

Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat për dënimin të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë, të cilat rrethana i aprovon edhe kolegji penal i kësaj gjykate, edhe bazuar në rrethanat relevante ekzistuese në rastin konkret, dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është përcaktuar në mënyrë të drejtë, dënimi me kushte është i ligjshëm, në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale të kryer dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit.

Kolegji penal i kësaj gjykate, vlerëson se me dënimin me kusht të shqiptuar të akuzuarit, do të arrihet qëllimi i dënimit, e i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, në kuptim të nenit 38 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT PRISHTINË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2024:060380, 29.10.2024**

Procesmbajtësi,

\_\_\_\_\_  
Mentor Grajçevci

Anëtarët e Kolegjit,

\_\_\_\_\_  
Violeta Husaj Rugova

\_\_\_\_\_  
Mehmet Ndrecaj

Kryetari i Kolegjit,

\_\_\_\_\_  
Zyhdi Haziri